

grami Buxhetor Afatmesem		2022- 2024			
Emri i Grupit	Ministria e Arsimit Sportit dhe Rinise	Kodi i Grupit	11		
Misioni					
<p>Misioni i Ministrisë së Arsimit Sportit dhe Rinisë është të sigurojë: Krijimin e një sistemi arsimor që ka në qendër nxënësit me nevojat dhe interesat e tyre, të krijojë kushte dhe mundësi që nxënësit të ndërtojnë dhe zhvillojnë njohuri, shkathtësi, qëndrime dhe vlera që kërkon shoqëria. Nxënësit të zhvillohen në mënyrë të pavarur e të gjithanshme, të kontribuojnë në ndërtimin e mirëqenies vetjake dhe të shoqërisë shqiptare dhe të përballen në mënyrë të përshtatshme dhe konstruktive me sfidat e jetës dhe mjedisit global. Edukimin e vlerave demokratike e kombëtare dhe zotërimin e njohurive dhe shprehive për ekonominë moderne të tregut; Edukim të mbështetur në të drejtat e njeriut në përgjithësi dhe të fëmijëve në veçanti; edukim cilësor; sipas nevojave dhe interesave të individit, komunitetit dhe shoqërisë në përgjithësi. Sipas standardeve evropiane; Arsimit bazë për të gjithë; Barazi të shanseve për arsimim për të gjithë qytetarët e Republikës së Shqipërisë. Mekanizmat e përgjegjshmërisë së shërbimit arsimor ndaj klientëve të drejtpërdrejt dhe shoqërisë civile në tërësi.</p> <p>Sigurimi dhe mbrojtja e të drejtave të shtetasve, që merren me edukim fizik dhe sport, në përputhje me Kartën Evropiane të Sportit dhe me rekomandimet e organizatave ndërkombëtare në këtë fushë. Ridimensionimi i edukimit fizik dhe sportiv si pjesë përbërëse e programit të edukimit të nxënësve dhe studentëve në institucionet arsimore. Të përmirsojmë cilësinë e jetës së të rinjve, përmes rritjes së pjesëmarrjes së tyre aktivitete rinore, në punësim, në informim, në edukim dhe në vendimarrje.</p> <p>Arsimi i lartë është e mirë dhe përgjegjësi publike dhe ka për mision, a) të krijojë, të zhvillojë, të përcjellë dhe të mbrojë dijet përmes mësimdhënies, kërkimit shkencor, si dhe të nxisë e të zhvillojë artet, edukimin fizik dhe sportet; b) të formojë specialistë të lartë dhe të përgatitë shkencëtarë të rinj, në përputhje me prioritetet e zhvillimit të vendit, duke kontribuar në rritjen e standardeve të demokracisë në vend; c) të ofrojë mundësi të barabarta për të përfutur nga arsimi i lartë dhe të mësuarit gjatë të gjithë jetës; ç) të kontribuojë në zhvillimin ekonomik, social dhe kulturor në nivel kombëtar dhe rajonal, si dhe në forcimin e sigurisë publike dhe kombëtare; d) të mbështesë prioritetet strategjike dhe interesat e zhvillimit të vendit; dh) të integrojë mësimdhënien me kërkimin shkencor; e) të nxisë bashkëpunimin ndërkombëtar në fushën e arsimit të lartë.</p> <p>Efektivitetin e administratës arsimore, maksimizimin, efektivitet dhe eficiencë i burimeve njerëzore, financiare dhe materiale në arsim.</p>					
Programet	v				
Titulli	Emri	Pershkrimi			
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	<p>Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi, synon fuqizimi i funksionit menaxhues të sistemit arsimor në nivelin qëndror dhe lokal, në funksion të implementimit të suksesshem të planeve strategjike dhe objektivave kombëtare të zhvillimit të arsimit. Përgatitja e akteve ligjore e nënligjore të sistemit arsimor në përputhje me legjislativon shqiptar e zhvillimin e tij sipas vlerave të përbashkëta të sistemeve bashkohore. Planifikimi dhe përdorimi me dobi, frytshmëri dhe transparencë të fondeve publike në përputhje me programin e qeverisë dhe strategjisë kombëtare për zhvillim dhe integrim. (SKZHI). Maksimizimin, efektivitet dhe eficiencë të burimeve burimeve njerëzore, financiare dhe materiale në arsim. Mekanizmat e përgjegjshmërisë së shërbimit arsimor ndaj klientëve të drejtpërdrejt dhe shoqërisë civile në tërësi.</p>			
08140	Zhvillimi i Sportit dhe Rinise	<p>Sigurimi dhe mbrojtja e të drejtave të shtetasve, që merren me edukim fizik dhe sport, në përputhje me Kartën Evropiane të Sportit dhe me rekomandimet e organizatave ndërkombëtare në këtë fushë. Ridimensionimi i edukimit fizik dhe sportiv si pjesë përbërëse e programit të edukimit të nxënësve, studentëve në institucionet arsimore. Të përmirsojmë cilësinë e jetës së të rinjve, përmes rritjes së pjesëmarrjes së të rinjve në aktivitete rinore, në punësim, në informim, në edukim dhe në vendimarrje.</p>			
09120	Arsimi Baze (perfshire parashkollorin)	<p>Programi synon krijimin e shanseve të barabarta për të gjithë nxënësit për një arsim cilësor, masiv dhe bashkëkohor; mirë menaxhim të burimeve njerëzore; fuqizimin dhe rritjen e autonomisë shkollore; shtrirjen dhe zgjerimin e arsimit të mesëm të përgjithshëm; për rritjen e nivelit të arsimimit të popullsisë, për ta përafëruar atë me standardet evropiane, për të përgatitur qytetarë më të aftë për një shoqëri demokratike.</p>			
09230	Arsimi i Mesem (i pergjithshem)	<p>Programi synon krijimin e mundësive që nxënësit që përfundojnë arsimin bazë të përfitojnë këtë shërbim arsimor në përputhje me format e përcaktuara në ligjin për sistemin parauniversitar. Përmirësimin e cilësisë së shërbimit arsimor të ofruar në këtë cikël të edukimit.</p>			
09450	Arsimi Universitar	<p>Programi i Arsimit Universitar synon zhvillimin e Arsimit të Lartë në përputhje me kërkesat e procesit të Bolonjës dhe të Hapsirës Evropiane të Arsimit të Lartë (HEAL) në funksion të progresit të vendit dhe integritetit evropian. Sistemi i financimit të arsimit të lartë reformohet për të optimizuar burimet financiare që në nivel kombëtar shkojnë në mbështetje të Arsimit të Lartë. Kjo reformë i përgjigjet kërkesës së lartë për shkollim, krijon hapësirë reale për nxitjen e partneritetit publik privat (PPP) dhe rrit autonominë qeverisëse të IAL. Ofrimi i studimeve universitare në të tre ciklet e studimit synohet nëpërmjet sigurimit të standardeve duke integruar në mënyrë më efektive mësimdhënien me kërkimin</p>			
09770	Fonde per Shkencen	<p>Programi për Kërkimin Fundamental dhe Fondin e Ekselencës synon të mbështesë kërkimin shkencor sipas prioritetëve kombëtare të zhvillimit shoqëror, ekonomik dhe kulturor të vendit, si dhe tendencave të zhvillimeve globale në shërbim të IAL-ve e komunitetit shkencor. Në këtë kuadër kërkohet që puna kërkimore-shkencore të vihet në funksion të zgjidhjes së problemeve dhe ofrimit të alternativave për zhvillimin e vendit.</p>			
Drejtuuesi i Ekipit Menaxhues te Programit	Emri	Sekretari i Pergjithshem	Emri	Ministri	Emri
	Firma		Firma		Firma
	Data		Data		Data